REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:294514
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05427253

C.nr.1867/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.H, Q.M, A.M dhe L.H nga Mitrovica, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Namon Merovci, avokat në Vushtrri, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria e Arsimit, me seli në Mitrovicë, me objekt kontesti, kompensimi i shujtës ushqimore, jashtë seance, me datë **08.03.2024**, mori këtë:

AKTGJYKIM
NË BAZË TË POHIMIT

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.H, Q.M, A.M dhe L.H, nga Mitrovica, **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit për shujtën ushqimore gjatë punës, t'ua paguajë dhe atë:

a). Paditëses **F.H,** për periudhën kohore nga data 11.03.2020, e deri më datë 22.11.2022, për 431 ditë të pranisë në punë, t'ia paguajë shumën prej 862.00 Euro.

b). Paditëses **Q.M,** për periudhën kohore nga data 11.03.2020, e deri më datë 22.11.2022, për 428 ditë të pranisë në punë, t'ia paguajë shumën prej 856.00 Euro.

c). Paditëses **A.M,** për periudhën kohore nga data 11.03.2020, e deri më datë 22.11.2022, për 425 ditë të pranisë në punë, t'ia paguajë shumën prej 850.00 Euro.

ç). Paditësit **L.H,** për periudhën kohore nga data 11.03.2020, e deri më datë 22.11.2022, për 216 ditë të pranisë në punë, t'ia paguajë shumën prej 432.00 Euro.

2021:294515

II. Detyrohet e paditura që shumat e aprovuara si në pikën I (një) të dispozitivit t'ua paguajë paditësve me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë të datës 29.12.2021, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësit F.H, Q.M, A.M dhe L.H nga Mitrovica, përmes të autorizuarit të tyre, kanë ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria e Arsimit, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit për shujtën ushqimore t'ua kompensoj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit, me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të padisë, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësve. Ka theksuar se paditësit me provat e bashkëngjitura padisë kanë dëshmuar ditët e pranisë në punë për periudhën kohorë gjatë të cilës kanë kërkuar kompensimin e shujtës ushqimore. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditëseve të aprovohet në tërësi si e bazuar. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës në shumë prej 312.00 Euro.

Gjykata në kuptim të nenit 148 paragrafi 2 të LPK-së, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurës ka konstatuar se në rastin konkret është fjala për kërkesa me të cilat palët mund të disponojnë lirisht, prandaj në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të LPK-së, gjykata pa shqyrtim të mëtejmë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 450 të LPK-së, ku përcaktohet se: *"Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta",* lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së, ku përcaktohet se: *"Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën",*

2021:294515

andaj, meqenëse paditësi nuk i ka specifikuar se cilat shpenzime të procedurës i kërkonë dhe sa është lartësia e tyre, gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale. Kurse të padituës nuk i takojnë shpenzimet e procedurës pasi i ka dhënë shkas padisë me mos përmbushjen e detyrimit ndaj paditësve.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1867/21, të datës 08.03.2024

Gjyqtari
Nderim Musa

_____

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.